



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Nr. 02-060/01-0074434-4/24, dt. 26.11.2024

Mitrovicë

PLANI I VEPRIMIT

**PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË KOMUNËN E
MITROVICËS SË JUGUT**

2025 - 2027

Nëntor 2024

Deklarata e Kryetarit të Komunës

Të nderuar qytetarë të Komunës së Mitrovicës së Jugut,

Plani i veprimit për personat me aftësi të kufizuar në komunën e Mitrovicës së Jugut, është kontribut i radhës për mbështetjen dhe fuqizimin e personave me aftësi të kufizuara si dhe dëshmon përkushtimin institucional ndaj këtij grupi të qytetarëve, me qëllim të sigurimit të shërbimeve kualitative për të gjithë qytetarët.

Synim i komunës mbetet siguri i ndryshimeve pozitive në shoqëri përmes institucioneve prandaj komuna e Mitrovicës së Jugut vazhdon fuqizimin e kapaciteteve të saja vepruese përmes hartimit të këtij dokumenti strategjik për shërbimet, situatën dhe fushat e ndërhyrjes për periudhën tre vjeçare për personat me aftësi të kufizuar. Ky dokument strategjik do të shërbejë në promovimin e të drejtave, dinjitetin dhe mirëqenien e kësaj kategorie të qytetarëve në shoqëri.

Personat me aftësi të kufizuara (PAK) duhet të përfshihen në të gjitha segmentet e shoqërisë si në atë ekonomik, politik, shoqëror dhe kulturor dhe pikërisht përmes këtij dokumenti komuna e Mitrovicës së Jugut do të dizajnoj mënyra për ndërhyrje dhe për të krijuar zgjidhje të qëndrueshme të sfidave të cilat hasen sot në procesin e përfshirjes së PAK në shoqëri.

Siguri i mbështetjes së plotë institucionale dhe pjesëmarrja aktive e PAK në jetën shoqërore dhe në zhvillim, promovim dhe avancim të drejtave të tyre, mbrojtja e dinjitetit dhe mbështetja për të pasur qasje të barabartë në punësim, arsim dhe shërbime janë dhe do të mbeten prioritetet e komunës. Veprimet e propozuara në këtë dokument, shprehin qartë hapat që do të ndërmerren me qëllim të përmbushjes së objektivave.

Me këtë rast, inkurajoj institucionet e qeverisjes lokale, përfaqësuesit e shoqërisë civile, komunitetin e bizneseve, komunitetin etnik dhe ndërkombëtar të bashkangjiten në nismen e zbatimit të këtij dokumenti strategjik dhe të punojmë së bashku me qëllim të ndërtimit të një qeverisje lokale e cila është në shërbim të qytetarëve.

Sinqerisht,

Bedri HAMZA,

Kryetar i Komunës së Mitrovicës së Jugut

Përmbajtja	
KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT	1
PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË KOMUNËN E MITROVICËS SË JUGUT	1
2025 - 2027	1
Parathënie	5
Hyrje	5
Përcaktimi i Aftësisë së Kufizuar	5
Parimet Themelore	6
Parimi i së drejtës shoqërore, barazisë dhe mosdiskriminimit	6
Parimi i Vetëvendosjes	6
Parimi i përfshirjes, pjesëmarrjes dhe mundësive të barabarta	6
Parimi i Jetesës pa Barriera dhe Mjedisit të Lirë	6
Parimet e Identifikimit dhe Trajtimit të Hershëm	6
Parimi i Rehabilitimit	6
Parimi i Qëllimshmërisë	6
Përmbledhja	7
Plani i aktiviteteve	8

Shkurtesat

AMF	Ambulanca e Mjekësisë Familjare
DMS	Drejtoria e Mirëqenies Sociale
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
DAP	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme
DBF	Drejtoria për Buxhet dhe Financa
DKRS	Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
DSHP	Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturë
DSh	Drejtoria e Shëndetësisë
DPU	Drejtoria e Planifikimit dhe Urbanizimit
FNVA	Fëmijë me Nevoja të Veçanta Arsimore
GP	Grupi Punues
IAL	Institucionet e Arsimit të Lartë
KK	Kuvendi i Komunës
PAK	Persona me Aftësi të Kufizuara
QPS	Qendra për Punë Sociale
QKMF	Qendra Kryesore e e Mjekësisë Familjare
OShC	Organizatat e Shoqërisë Civile
SKPAK	Strategjia Komunale Për Persona me Aftësi të Kufizuara
ZBGj	Zyra për Barazi Gjinore
ZDNj	Zyra për të Drejta të Njeriut
ZL	Zyra Ligjore
ZK	Zyra e Kryetarit
OPAK	Organizatrat për personat me aftësi të kufizura

Parathënie

Personat me aftësi të kufizuara (PAK), përbëjnë një numër të konsiderueshëm të popullsisë në Komunën e Mitrovicës së Jugut. Ky grup i qytetarëve nuk kanë qasje në shërbime profesionale psiko-sociale dhe shëndetësore. Gjithashtu komuniteti i PAK, janë të diskriminuar në shfrytëzimin e qasjes në hapësirat publike, përfshirë dhe objektet e institucioneve publike dhe të mirat e tjera që ofrohen nga komuna për qytetarët e saj. Në vitin 2013 është zhvilluar Strategjia Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara për një periudhë 10 vjeçare e cila ndër të tjerash parasheh edhe krijimin e planeve komunale për aftësinë e kufizuar. Mirëpo deri më tani, ky hap i rëndësishëm për PAK, nuk është ndërmarrë dhe komuna e Mitrovicës së Jugut ende nuk e ka zhvilluar planin e saj të veprimit për personat me aftësi të kufizuara, prandaj paraqitet problem në zhvillimin e aktiviteteve si dhe në buxhetimin adekuat për plotësimin e nevojave të këtij grupi të qytetarëve. Marrë në konsideratë nevojat dhe kërkesat e komunitetit të PAK, Shoqata Down Syndrome Kosova, ka iniciuar hartimin e këtij plani me vendim të kryetarit të komunës, z. Bedri Hamza. Komuna e Mitrovicës së Jugut, ka njohur faktin se mungesa e planit të aktiviteteve ka vështirësuar gjendjen e personave me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, mungesa e bashkëpunimit të deritanishëm në mes të përfaqësuesve të strukturave të komunës dhe përfaqësuesve të personave me aftësi të kufizuara ka rezultuar në shtyrjen e përpilimit të planit të përbashkët të veprimit, i cili do të definoj mënyrat për të ofruar shërbime për të gjithë qytetarët pa pasur diskriminime të asnjë lloji. Qasja e personave me aftësi të kufizuara në shërbime dhe të mira të tjera nuk mund të konsiderohen dytësore por të trajtohen me prioritet maksimal.

Plani i hartuar i veprimit për personat me aftësi të kufizuara u mundëson PAK, të kenë mundësi të barabarta për të marrë pjesë në aktivitetet ekonomike, sociale, kulturore dhe politike. Ky plan i veprimit për aftësinë e kufizuar ka një definicion të gjerë duke marrë parasysh përfshirjen e të gjitha kategorive të aftësisë së kufizuar si: intelektuale, fizike, dëgjimore dhe vizuale.

Hyrje

Plani i veprimit komunal për Personat me Aftësi të Kufizuara (PAK) në komunën e Mitrovicës së Jugut, është hartuar në përputhje dhe në kuadër të zbatimit të Strategjisë Nacionale Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në Republikën e Kosovës 2013 - 2023 dhe të Planit të Veprimit Për Zbatimin e Strategjisë Nacionale Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në Republikën e Kosovës 2013 – 2015.

Qëllimi i planit të veprimit, është gjithëpërfshirja, eliminimi i barrierave ekzistuese dhe përmirësimi i cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara, përmes gëzimit të të drejtave bazë në arsim, shërbime cilësore shëndetësore dhe psiko-sociale dhe krijimin e kushteve për punësim.

Përcaktimi i Aftësisë së Kufizuar

Në përputhje me terminologjinë e Kombeve të Bashkuara, me konceptin e mundësive të barabarta të personave me aftësi të kufizuara si dhe në përputhje me kategorizimin ndërkombëtar të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH), termi "person me handicap" është zëvendësuar me termin "Person me Aftësi të Kufizuara" (individualisht) dhe "Persona me Aftësi të Kufizuara" (në nivel shoqëror).

Parimet Themelore

Ky dokument strategjik, për të gjitha palët e interesit, si ato të organizatave të shoqërisë civile ashtu edhe nga institucionet e qeverisjes lokale dhe qendrore, duhet të udhëhiqet nga parimet e përgjithshme të së drejtës për të qenë pjesë e shoqërisë kosovare. Janë gjithsej shtatë parime në bazë të së cilave është hartuar plani i veprimit për PAK për komunën e Mitrovicës së Jugut.

Parimi i së drejtës shoqërore, barazisë dhe mos diskriminimit

Personat me aftësi të kufizuara janë anëtarë të barabartë të shoqërisë; ata mund të kërkojnë të njëjtat të drejta dhe të përfitojnë të njëjtën ndihmë sociale dhe llojet e asistencës si gjithë qytetarët e tjerë; ata nuk duhet të diskriminohen në asnjë fushë të jetës shoqërore. Tutje, ky parim promovon barazinë gjinore duke iu garantuar të drejtat të gjithë individëve pavarësisht aftësive dhe gjinisë, me qëllim të krijimit të kushteve që mundësojnë integrimin dhe pjesëmarrjen aktive të individëve me AK, duke marrë në konsideratë dhe dimensionin gjinor duke iu përshtatur nevojave.

Parimi i Vetëvendosjes

Vjen nga përjasja me të drejtën shoqërore dhe nënkupton që mjedisi ku jetojnë personat me aftësi të kufizuara, duhet të ndërtohet në mënyrë të tillë që t'i inkurajojë ata të jetojnë një jetë të pavarur dhe të jenë në gjendje të vendosin vet. Vetëvendosja ka të bëjë gjithashtu me të drejtën për të menaxhuar lëvizjet, kohën dhe pasurinë individuale. Ky parim gjithashtu parashikon që çdo masë në lidhje me rehabilitimin duhet të ndërmerret në bashkëpunim me personat me aftësi të kufizuara. Ai/ajo nuk duhet të trajtohet asnjëherë pa pëlqimin e tij/saj.

Parimi i përfshirjes, pjesëmarrjes dhe mundësive të barabarta

Personat me aftësi të kufizuara janë pjesë e shoqërisë ku ata jetojnë, prandaj nuk kanë pse të integrohen, sepse zotërojnë të njëjtat të drejta si njerëzit me zhvillim tipik. Ata kanë përfitime që i lejojnë të marrin pjesë plotësisht në të gjitha fushat e jetës shoqërore, ku përfshihet rehabilitimi mjekësor, pjesëmarrja në jetën në komunitet dhe në punë. Jetesa pa pengesa është një kusht i rëndësishëm për pjesëmarrje.

Parimi i Jetesës pa Barriera dhe Mjedisit të Lirë

Ndërtesat dhe shërbimet e tjera, mjetet e transportit, pajisjet teknike, sistemet e përpunimit të informacionit, burimet akustike dhe vizuale të shërbimeve informative dhe të komunikimit dhe mjediset e tjera të krijuara konsiderohen papengesa (pa barriera), nëse ato zakonisht përdoren nga personat me aftësi të kufizuara pa vështirësi të veçanta dhe si rregull pa ndihmën e të tjerëve.

Parimet e Identifikimit dhe Trajtimit të Hershëm

Ky parim ka të bëjë me identifikimin e rasteve që nga fëmijëria duke iu ofruar mbështetje profesionale përmes intervenimit të hershëm me shërbime cilësore shëndetësore dhe terapeutike.

Parimi i Rehabilitimit

Qëndron në bazë të procesit, i cili u siguron personave me aftësi të kufizuara mjetet dhe rrugët për një jetesë të pavarur. Ky parim, ka të bëjë me trajtimin e personit si tërësi me theks në aftësitë e tij/saj. Ndër të tjera, parimi i rehabilitimit fokusohet tek rastet në mënyrë profesionale për qëllim të krijimit të kushteve të barabarta sociale, në edukim, arsim, rekreacion, punësim dhe kujdes familjar.

Parimi i Qëllimshmerisë

Parashikon ndihmën që duhet t'i ofrohet çdo personi me aftësi të kufizuara, pavarësisht nga aftësia e kufizuar, edhe nëse përgjegjësia për këtë ndihmë mbahet nga fondet e dhëna nga institucione të ndryshme.

Përmbledhja

Plani komunal i veprimit për aftësinë e kufizuar është dokument publik i rëndësishëm, i cili përshkruan konceptet se si komuna do t'i qaset diversitetit dhe gjithëpërfshirës si dhe specifikon synimet dhe planet e saj për të eliminuar diskriminimin në raport me qytetarët me aftësi të kufizuara. Planet e veprimit të aftësisë së kufizuar njihen edhe si plane për “qasje dhe integrim” dhe i mundësojnë komunës të arrijë një numër të qëllimeve. Ato i asistojnë komunës që të njoh më mirë nevojat dhe prioritetet e PAK. Planet e veprimit për PAK, minimizojnë mundësinë për të diskriminuar qytetarët në bazë të aftësisë së kufizuar si dhe fokusimin e shpenzimeve në fusha të rëndësishme të lartë duke klasifikuar prioritetet. Planet e veprimit për PAK, janë dokumente formale me kërkesa të veçanta të identifikuara nga vetë-qytetarët me aftësi të kufizuara si dhe me organizatat që përfaqësojnë grupe të ndryshme të qytetarëve me përfaqësuesit/et e personave me aftësi të kufizuara, të cilat bazohen në të drejtat e njeriut. Plani aktual i veprimit është rezultat i iniciativës të shoqatës Down Syndrome Kosova mbështetur nga UNICEF në partneritet me USAID. Gjatë hartimit të këtij plani kontribut të veçantë përveç shoqatës Down Syndrome Kosova kanë dhënë edhe pesë shoqata të tjera të shoqërisë civile si: Handikos Mitrovica, OPFAKos, Shoqata e të Verbërve, Shoqata e të Shurdhërve dhe Hendifer, të cilat merren me aftësinë e kufizuar dhe kanë konsistencë të qartë në misionin e tyre. Gjithashtu kontribut të rëndësishëm kanë dhënë dhe grupi i përfaqësuesve komunal i emëruar nga kryetari i komunës së Mitrovicës së Jugut. Ky grup, ka mbuluar drejtoritë relevante të komunës dhe ka dhënë kontribut në specifikimin dhe qartësimin e aktiviteteve. Për më shumë, komuna e Mitrovicës së Jugut, aktualisht ka në funksion komitetin konsultativ për shëndetësi, mirëqenie sociale dhe për persona me aftësi të kufizuar të cilët do të rrisin bashkëpunimin, koordinimin dhe monitorim e këtij dokumenti.

Plani i aktiviteteve

Objektiva	1. Përmirësimi i mirëqenies sociale dhe shërbimeve shëndetësore								
	Aktivitetet	Institucioni përgjegjës	Viti i implementimit			Indikatorët	Buxheti në €		
			2025	2026	2027		2025	2026	2027
1.1. Janë përmirësuar shërbimet terapeutike dhe mbështetëse për personat me aftësi të kufizuara.	Kontraktimi i organizatave të licencuara për ofrim të shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara.	DMS DSH Donatorët	X	X	X	1.1.1 Numri i shërbimeve të kontraktuara	100,000.00	100,000.00	100,000.00
1.2. Janë monitoruar OJQ-të, e kontraktuara për cilësinë e shërbimeve të ofruara 1.3. Është krijuar sistemi mbikëqyrës dhe raportues mbi zbatimin e planit për PAK	Monitorimi dhe vlerësimi i shërbimeve të ofruara nga OJQ-të, e kontraktuara	DMS DSH Donatorët	X	X	X	1.1.1. Numri i OJQ-ve, të kontraktuara 1.1.2. Raporti periodik për cilësinë e shërbimeve të ofruara nga monitorimet e realizuara dhe matja e kënaqësisë së përdoruesve të shërbimeve	1,000.00	1,000.00	1,000.00
	Krijimi dhe zbatimi i sistemit mbikëqyrës dhe raportues për zbatimin e planit për PAK	DMS DSH	X	X	X	1.3.1 Numri i takimeve të mbajtura 1.3.2. Publikimi i raportit të progresit	200	200	200
	Organizimi i fushatave vetëdijësuese mbi të drejtat e komunitetit PAK – njohja dhe respektimi i tyre	DMS ZDNJ	X	X	X	1.3.1 Numri i fushatave të realizuara dhe % e qytetarëve të informuara për shërbimet për PAK.	3,000.00	3,000.00	3,000.00
1.4. Janë liruar personat me aftësi të kufizuara nga tatimi në pronë.	Nxjerrja e vendimit për lirim të të gjithë personave me aftësi të kufizuara, për tatim në pronë	DSHPI	X	X	X	1.4.1. Numri i vendimeve të nxjerra			

<p>1.5. Janë siguruar vizitat në shtëpi nga specialisti i mjekësisë familjare.</p> <p>1.6. Janë krijuar kushtet për punë të organizatave të shoqërisë civile që punojnë me aftësi të kufizuara.</p> <p>1.7. Janë siguruar shërbimet terapeutike për personat me aftësi të kufizuar.</p>	Vizitat e rregullta nëpër familje të personave me aftësi të kufizuara.	DSH	X	X	X	1.5.1. Numri i familjeve të vizituara 1.5.2. Numri i vizitave në përgjithësi 1.5.3. Përmes instrumentit matës “anketës” do të matet cilësia e shërbimit nga përfituesit dhe familjarët e tyre	30,000.00	30,000.00	30,000.00
	Rregullimi i hapësirave të punës së organizatave të shoqërisë civile që punojnë me personat me aftësi të kufizuara.	DSHPI	X	X		1.6.1. Numri i organizatave përfituese nga rregullimi i hapësirave	50,000.00	50,000.00	
	Mbulimi i shpenzimeve komunale për OJQ-të që ofrojnë shërbime për persona me aftësi të kufizuara.	DSHPI	X	X	X	1.7.1. Numri i OJQ-ve përfituese nga mbulesa e shërbimeve komunale.	15,000.00	15,000.00	15,000.00
	Ngritja e vetëdijes së publikut dhe zyrtarëve për punësim të personave me aftësi të kufizuara.	Zyra e Kryetarit	X	X	X	1.7.2. Numri i trajnimeve të zyrtarëve	200	200	200
Objektiva	2. Përmirësimi i gjithë përfshirjes në jetën publike								
Rezultatet	Aktivitetet	Institucioni përgjegjës	Viti i implementimit			Indikatorët	Buxheti ne €		
			2025	2026	2027		2025	2026	2027
2.1. Perceptimet dhe qëndrimet e komunitetit rreth personave me aftësi të kufizuara janë përmirësuar, dhe përfshirja e PAK në jetën sociale, kulturore dhe ekonomike është rritur pas realizimit të fushatës vetëdijësuese	Fushata vetëdijësuese për të ndryshuar perceptimet e komunitetit rreth personave me aftësi të kufizuar dhe për të promovuar përfshirjen e plotë të PAK në jetën sociale, kulturore dhe ekonomike	Zyra e Kryetarit ZDNJ	X	X	X	2.1. Numri i fushatave të realizuara dhe % e qytetarëve të përfshirë	5,000.00	5,000.00	5,000.00

2.2. Këshilli për PAK është formuar dhe ka filluar bashkëpunimin me komunën në hartimin dhe vlerësimin e politikave dhe planeve për personat me aftësi të kufizuara	Formimi i një këshilli për PAK që do të bashkëpunojë me komunën në hartimin dhe vlerësimin e politikave dhe planeve për këtë kategori	ZK ZDNJ DMS DSH	X	X	X	2.2. Numri i takimeve të këshillit dhe numri i rekomandimeve të propozuara dhe të implementuara			
2.3. Janë fuqizuar mekanizmat për identifikimin e hershëm të aftësisë së kufizuara.	Trajnimi i personelit mjekësor për identifikim të hershëm të aftësi së kufizuara.	DSH DKA	X	X	X	2.3.1. Numri i trajnimeve të mbajtura 2.3.2. Numri i personelit të trajnuar	450	450	450
2.4. Është krijuar databaza e integruar për personat me aftësi të kufizuara.	Krijim i databazës së integruar për të gjithë personat me aftësi të kufizuara.	ZDNJ DKA QPS OSHC QMF				2.4.1. Numri i personave të përfshirë në databazë 2.4.1.1. Përqindja e burrave dhe grave që kanë akses në shërbime të caktuara (shëndetësore, edukative, punësimi) krahasuar me nivelin e mundësive për çdo gjini. 2.4.1.2. Në çfarë mase shërbimet e veçanta janë të disponueshme për gratë me aftësi të kufizuara, si dhe cilësia e shërbimeve të shëndetit riprodhues dhe mbështetjes emocionale për këtë grup.	200	200	200
	Njoftimi i personave me aftësi të kufizuara për regjistrim në databazë.	ZDNJ OSHC DKA QPS	X	X	X	2.4.1.1. Numri i publikimeve Numri i klikimeve në publikime	200	200	200

	Azhurnimi periodik gjashtë-mujor i databazës.	ZDNJ	X	X	X	2.4.2. Numri i azhurnimeve			
2.5 Janë krijuar mekanizma lehtësues për gjithë përfshirjen sistemin e rregullt arsimor.	Vlerësimi i fëmijëve me NVA, nga ekipa komunale pedagogjike	DKA	X	X	X	2.5.1 Numri i fëmijëve të vlerësuar nga ekipa komunale pedagogjike 2.5.2 Raportet vlerësuese të fëmijëve të vlerësuar			
	Sigurimi i transportit për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore.	DKA	X	X	X	2.5.3 Numri i fëmijëve përfitues	10,000.00	10,000.00	10,000.00
	Punësimi i asistentëve – Profili asistent/e për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.	DKA	X	X	X	2.5.4. Numri i asistentëve të caktuar.			
	Angazhimi i mësuesve mbështetës për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.	DKA	x	X	X	2.5.5 Numri i mësuesve mbështetës të angazhuar.	40,000.00	40,000.00	40,000.00
Objektiva	3. Punësimi i personave me aftësi të kufizuara.								
Rezultatet	Aktivitetet	Institucioni përgjegjës	Viti i implementimit			Indikatorët	Buxheti		
			2025	2026	2027		2025	2026	2027
3.1. Janë krijuar dhe implementuar programe praktikash profesionale me pagesë për personat me aftësi të kufizuara (PAK) në bashkëpunim me institucionet publike dhe bizneset lokale, duke ofruar mundësi punësimi afatshkurtra dhe përvojë pune 3.2. Është siguruar respektimi i kuotës për	Krijimi i programeve të praktikave profesionale me pagesë në bashkëpunim me institucionet publike dhe bizneset lokale për të ofruar mundësi punësimi afatshkurtra dhe përvojë pune për PAK.	ZK DKRS DZHET	X	X	X	3.1. Numri i PAK të përfshirë në programe praktike dhe numri i vendeve të punës të krijuara pas përfundimit të praktikës	10,000.00	10,000.00	10,000.00

punësim të personave me aftësi të kufizuara në sektorin publik									
	Inkurajimi i personave me aftësi të kufizuara për aplikim në konkurse të punës.	Zyra e Kryetarit	X	X	X	3.1.1 Numri i publikimeve në mediat sociale 3.1.2 Numri i klikimeve në publikime 3.1.3. Numri i aplikimeve të PAK në konkurse publike	200	200	200
	Bashkëpunimi me shoqërinë civile për përpilim të kritereve të punësimit të personave me aftësi të kufizuara.	Zyra e personelit	X	X	X	3.1.4 Numri i kritereve të përpiluara			
	Krijimi i kushteve për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar në QAP përmes trajnimeve profesionale	ZK QAP DMS OJQ	X	X	X	3.1.5. Numri i PAK të përfshirë në trajnime			
	Inkurajimi i personave me aftësi të kufizuara për regjistrim në qendrat regjionale për punësim.	OSHC	x	X	x	3.1.6 Numri i publikimeve në mediat sociale 3.1.7 Numri i klikimeve në publikime	200	200	200
	Bashkëpunimi me bizneset vendore për punësim të personave me aftësi të kufizuara.	DZHE / Zyra Regjionale e Punësimit	X	X	X	3.1.8 Numri i bizneseve të kontaktuara 3.1.9 Numri i bizneseve që kanë punësuar persona me aftësi të kufizuar			
	Hartimi dhe shpërndarja e udhëzuesve për punësimin e	DZHE Zyra Regjionale Punësimit dhe Kryetari	X	X		3.1.10. Numri i udhëzuesve të shpërndarë	2,000.00	2,000.00	

	personave me aftësi të kufizuara (PAK) për bizneset, duke përfshirë informacione rreth lehtësive, përfitimeve, dhe përgatitjes së vendeve të punës për PAK								
	Subvencionimi i ngritjes së kapaciteteve profesionale të personave me aftësi të kufizuara.	DKRS / ZDNJ	x	X	x	3.1.11 Numri i personave me aftësi të kufizuar të përkrahur	9,000.00	12,000.00	12,000.00
	Subvencionimi i përgatitjes profesionale me punë praktike për personat me aftësi të kufizuara.	DMS	x	X	x	3.1.12 Numri i pozitive të punës të subvencionuara	9,000.00	12,000.00	12,000.00
	Ngritja e vetëdijes së publikut dhe zyrtarëve për punësim të personave me aftësi të kufizuara.	Zyra e Kryetarit	x	X	x	3.1.13 Numri i publikimeve në mediat sociale 3.1.14 Numri i klikimeve në publikime	200	200	200
Objektiva	4. Sigurimi i qasjes dhe lirisë së lëvizjes për personat me aftësi të kufizuara								
Rezultatet	Aktivitetet	Institucioni përgjegjës	Viti i implementimit			Indikatorët	Buxheti		
			2025	2026	2027		2025	2026	2027
4.1. Janë identifikuar objektet me pengesa në qasje.	Vlerësimi i objekteve publike me pengesa në qasje.	DPU	X			4.1.1 Numri i objekteve të identifikuara			
	Rregullimi i qasjes në objektet publike.	DSHPI	x	X	x	4.1.2 Numri i objekteve ku është rregulluar qasja	30,000.00	30,000.00	30,000.00
	Rregullimi i qasjes (rampat, dyert, tualetet dhe trafik urban) në shkolla	DSHPI / DKA	x	X	X	4.1.3 Numri i shkollave ku është rregulluar qasja	20,000.00	20,000.00	20,000.00

	fillore dhe të mesme.								
	Krijimi i një mekanizmi monitorimi për inspektimin dhe shqyrtimin e vazhdueshëm të objekteve publike për të siguruar që ato janë të përshtatshme dhe të qasshme për personat me aftësi të kufizuara (PAK)	DSHPI	X	X	X	4.1.4. Numri i objekteve të vlerësuara			
4.2. Është mundësuar liria e lëvizjes për personat me aftësi të kufizuara.	Lirimi i parkingjeve të rezervuara për personat me aftësi të kufizuara.	DPU Policia e Kosovës	x	X	x	4.2.1 Numri i parkingjeve të liruara			
	Subvencionimi për rregullimin e qasjes për familjet me anëtarë me aftësi të kufizuara.	DMS	x	X	x	4.2.2. Numri i familjeve të subvencionuara	5,000.00	5,000.00	5,000.00
	Vendosja e sinjalistikës akustike në udhëkryqe në zona strategjike dhe me frekuentim të lartë për të siguruar efektshmëri.	DSHPI	x	X	X	4.2.3 Numri i udhëkryqeve ku është vendosur sinjalistika akustike	500	500	500
	Zgjidhja e problemit të shtyllave për pengim të parkimit të makinave.	DSHPI	x	X	X	4.2.4 Numri i shtyllave të larguara	??	??	??
	Vendosja e pllakave taktile në trotuare për mundësim të lëvizjes e lirë dhe	DPU / DSHPI	x	X	x	4.2.5 Metrat e trotuareve të rregulluara me pllaka taktile	??	??	??

	orientimin e personave të verbër								
4.3. Është siguruar pjesëmarrja e përfaqësuesit të personave me aftësi të kufizuara në komisionin për vlerësim dhe aprovim të projekteve.	Ofrimi i programeve të dedikuara për aftësitë e jetës së pavarur për PAK si: kurse për orientim në hapësira publike dhe përdorimin e transportit publik	ZK DSHPI DMS	X	X		4.3.3 Numri i programeve të ofruara 4.3.4. Numri i pjesëmarrësve në program	5,000.00	5,000.00	
	Nxjerrja e vendimit për pjesëmarrjen e përfaqësuesit të zyrës për të drejtat e njeriut në komisionet për vlerësim dhe aprovim të projekteve të komunës.	Zyra e Kryetarit				4.3.1 Numri i vendimeve të nxjerra 4.3.2 Numri i takimeve ku ka marrë pjesë zyrtari për të drejtat e njeriut.			

Plani i veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara në komunën e Mitrovicës së Jugut 2025-2027 është inicuar dhe realizuar nga Shoqata Down Syndrome Kosova, mbështetur nga UNICEF në partneritet me USAID, në kuadër të projektit “Fuqizimi i cilësisë së shërbimeve të integruara, efektive dhe të qëndrueshme për fëmijët dhe adoleshentët aftësi të kufizuar intelektuale” që zbatohet nga Shoqata Down Syndrome Kosova.